VENDIM
Nr. 148, datë 6.3.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 104, DATË 28.2.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR NXËNËSIT NË DIASPORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 49, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 104, datë 28.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë", bëhen shtesat e mëposhtme:

a) në fund të pikës 8 shtohen fjalët, me këtë përmbajtje:

"... i cili lëshon vërtetim për mësuesit, që janë pjesë e këtij regjistri.";

b) pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

"11/1. Për nxënësit që kanë ndjekur programin e mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë lëshohet vërtetim i pjesëmarrjes nga autoritetet që organizojnë mësimin e gjuhës e të kulturës shqiptare në diasporë. Ky vërtetim prodhohet nga Qendra e Botimeve të Diasporës, sipas modelit dhe kërkesave të përcjella nga misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku